

PROCESVERBAL
nga seanca e 32-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime
Mediatike Audio dhe Audiovizuale
mbajtur më 07.08.2024

Anëtarët e pranishëm të Këshillit të Agjencisë nëpërmjet lidhjes video-konferencë: Lazo Petrushevski kryetar i Këshillit të ASHMA-së, Selver Ajdini zëvendës kryetar i Këshillit të ASHMA-së, mr. Alma Mashoviq, Lazar Trajçev, Zoran Fidanoski, dr. Metodija Jançeski.

Anëtarët në mungesë të Këshillit të Agjencisë : /

Në seancë nuk ishte i pranishëm dr. Zoran Trajçevski, drejtor i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale (pushim vjetor).

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit - Shefe kabineti mr. Dragica Ljubevska e ka zëvendësuar drejtorin e Agjencisë në përputhje me Autorizimin ark.nr.03-2745/1 datë 13.06.2024.

Të pranishëm nga Shërbimi profesional nëpërmjet lidhjes video-konferencë: mr. Dragica Ljubevska, Cvetanka Mitrevska, mr. Magdalena Davidovska Dovleva, mr. Arben Saiti, Maja Damevska, mr. Ruzhica Boshnakoska Jotevska, dr. Ivana Stojanovska.

Të pranishmit e tjerë: /

Z. Petrushevski hapi seancën e 32-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale. Seanca filloi në ora 14:05 dhe u mbajt nëpërmjet lidhjes video-konferencë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri, me 6 vota "pro", miratoi:

RENDIN E DITËS

1. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 9-të publike e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 29.07.2024.
2. Miratimi i Propozim-procesverbalit nga seanca e 31-të e Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 29.07.2024.
3. Propozim për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar.
4. Propozim-vendim për refuzim të kërkesës me shkrim të palës së interesuari për marrjen e vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënie të lejes për transmetim në radio të shërbimi programor të një institucioni radiodifuziv jofitimprurës, në nivel rajonal, në zona e qytetit të Shkupit.
5. Propozim-vendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV – KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.

6. Propozim-vendim për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar.
7. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Test për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit dhe faqeve të internetit të Agjencisë.
8. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Hulumtim - Analiza të çështjeve gjinore dhe mënyra e përfaqësimit dhe prezantimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve.
9. Propozim për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mbajtja e Ditëve të Arsimit Mediatik 2024.
10. Propozim-vendim për pagesën e dëmshpërblimit për vdekjen e anëtari të familjes të punësuar në Shërbimin profesional të Agjencisë.
11. Të ndryshme.

Pika 1

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 9-të publike të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 29.07.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 2

Këshilli i Agjencisë shqyrtoi dhe njëzëri miratoi Procesverbalin e seancës së 31-të të Këshillit të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, mbajtur më 29.07.2024, me tekstin e propozuar.

Pika 3

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit - shefe e kabinetit mr.Dragica Ljubevska, shpjegoi Propozimin për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar. Ajo ka shpjeguar se më 24 korrik të këtij viti është bërë mbikëqyrje kontrolli mbi transmetuesin dhe është konstatuar se nuk ka vepruar sipas masës së shqiptuar vërejtje publike dhe nuk e ka përmbushur detyrimin nga neni 15 paragrafi (1) të Ligjit për Media, sipas të cilës transmetuesit janë të detyruar deri më 31 mars të vitit aktual të dorëzojnë formularin e përcaktuar nga Agjencia me të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin përgjegjës /redaktorët, burimet e financimit në vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara nga ofrimi i aktivitetit në vitin 2023 dhe për dëgjueshmërinë mesatare në 2023. Afati prej 45 ditësh për dorëzimin e dokumentit ka mbaruar më 19 korrik. Në këtë drejtim, Shërbimi profesional në disa raste ka pasur bisedë telefonike me radion, por dhe përkundër kësaj, transmetuesi nuk ka dorëzuar dokumentacionin e nevojshëm në Agjenci. Për këtë arsye, propozohet që të inicohet procedurë për heqjen e lejes.

Z. Petrushevski theksoi se dhe herën e fundit kur ka pasur propozim për masë vërejtje publike ka bërë vërejtje në kuptimin se sa i rreptë është Ligji për mos respektim të nenit 15

paragrafi (1) të Ligjit për Media , sepse në këtë rast nuk bëhet fjalë për gjobë, por për dënimin më të rëndë, që është heqja e lejes për transmetim. Ai tha se nuk e kupton median pse ka vepruar kështu, dhe Këshilli nuk ka zgjidhje tjetër në votim veç zbatimit të ligjit.

Z. Ajdini tha se sipas materialeve ka parë se është kontaktuar me pronarin apo redaktorin e radios dhe ka pyetur nëse këto ditë ndonjë nga Shërbimi profesional ka folur me dikë nga radio sërish?

Udhëheqësja e Sektorit për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit mr.Magdalena Davidovska Dogleva, informoi se disa herë kolegia nga Njësia për planifikim strategjik ka kontaktuar dhe kjo thuhet në Raportin nga mbikëqyrja e kontrollit. Biseda telefonike është zhvilluar në disa raste me njërin nga pronarët dhe personin përgjegjës, udhëheqësin z. Pajtim Saiti, por pavarësisht kësaj nuk kanë dorëzuar asnjë dokument.

Z. Petrushevski tha se kanë ende kohë sepse do të kenë edhe 15 ditë shtesë dhe shpreson se do të veprojnë sipas ligjit.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka iniciuar procedurë për heqjen e lejes për transmetim në radio të SHTR RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, për shkak se transmetuesi nuk ka vepruar sipas Akvendimit për marrjen e masës – vërejtje publike nr.03-167, datë 31.05.2024, pas kryerjes së mbikëqyrjes së rregullt administrative (Raporti me shkrim mbi mbikëqyrjen e kryer administrative nr. 03-2120/1, datë 29.04.2024) dhe nuk ka përmbushur detyrimin nga neni 15 paragrafi (1) i Ligjit për Media.

Nëse transmetuesi i lartpërmendur drejtuar Agjencisë nuk dorëzon të dhëna për strukturën e pronësisë, redaktorin/redaktorët përgjegjës, burimet e financimit në vitin 2023, të ardhurat dhe shpenzimet totale të realizuara nga ofrimi i aktivitetit në vitin 2023 dhe për dëgjueshmërinë mesatare në 2023, Këshilli i Agjencisë në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e pranimit të Propozimit për iniciimin e procedurës për heqjen e lejes, do të marrë Vendim për heqjen e lejes për transmetim në radio të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive RADIO PRO-FM SHPK Gostivar, PA1 nr. 08-95 datë 07.09.2023, për shkak të shkeljes së lartpërmendur të LM, dhe në pajtim me nenin 83 paragrafi (3) të LSHMAAV.

Z. Petrushevski, pas votimit tha se Shërbimi profesional duhet të bëjë përpjekje dhe të kontaktojë edhe një herë, për ta informuar për afatet dhe seriozitetin e pasojave nëse nuk respektohet neni 15 paragrafi (1) nga LM.

Pika 4

Udhëheqësja Ljubevska ka shpjeguar Propozim-vendimin për refuzimin e kërkesës me shkrim të palës së interesuar për miratimin e Vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit radiodifuziv jofitimprurës, në nivel rajonal, në zonën e qytetit të Shkupit. Ajo ka sqaruar se Asociacioni i Qytetarëve për Afirmim dhe Promovim të Moto Kulturës BAJKERS GARAZH Shkup e ka dorëzuar kërkesën e mësipërme në Agjenci, por meqenëse u shpallën zgjedhjet për kryetar të shtetit dhe zgjedhjet për deputet, Agjencia ka njoftuar parashtuesin e Kërkesës se procedura do të vazhdojë pas përfundimit të zgjedhjeve dhe pas formimit të Qeverisë. Pas përfundimit zyrtar të zgjedhjeve, Agjencia i kërkoi parashtuesit të Kërkesës të deklarohej nëse është ende i interesuar për marrjen e lejes. Pas marrjes së përgjigjes pozitive, Agjencia iu drejtua Agjencisë për Komunikime Elektronike, e cila më 1 gusht ka dorëzuar Njoftim se për zonën e shërbimit - qyteti i Shkupit nuk ka mundësi për përcaktimin e ndarjes së re të

frekuencave. Sipas LSHMAAV dhe duke pasur parasysh se nuk ka frekuenca të lira, propozohet që kjo Kërkesë të refuzohet.

Z. Petrushevski tha se ishte e pritshme Kërkesa për t'u refuzuar për shkak se nuk ka frekuenca të lira sepse Shkupi si kryeqytet i vendit është një zonë mjaft tërheqëse që ofron mundësi për të ardhura më të larta.

Z. Fidanoski tha se i vjen keq që nuk ka frekuencë të lirë në zonën e Shkupit, por kështu është dhe ASHMA nuk mund të ndryshojë asgjë. Ai personalisht beson, shpreson të mos jetë gabim në vlerësimin e tij, se peizazhi mediatik do të ishte pasuruar nga një radio e tillë jofitimprurëse që do të kishte target grupin e vet të dëgjuesve.

Z. Ajdini tha se i vjen keq që për arsye teknike nuk mund të shpallet konkurs publik për dhënien e lejes për transmetim në radio. Ai shpjegoi se e kishte shqyrtuar Kërkesën dhe se skema programore për të ishte shumë interesante me emisionet e ofruara nga pala e interesuar, por fatkeqësisht është propozuar që Kërkesa të refuzohet për shkak të mungesës së frekuencës.

Këshilli i Agjencisë njëzëri ka marrë Vendim me të cilin refuzohet Kërkesa me shkrim nga ana e palës së interesuar, Shoqata e Qytetarëve për Afirmim dhe Promovim të Moto Kulturës BAJKERS GARAZH Shkup, ark.nr.08-1432/1, datë 26.03.2024 me plotësim ark. nr.08-1432/4 datë 08.07.2024 për marrjen e vendimit për shpalljen e konkursit publik për dhënien e lejes për transmetim në radio të shërbimit programor të institucionit radiodifuziv jofitimprurës, në nivel rajonal, në zonën e qytetit të Shkupit, duke pasur parasysh se në pajtim me Planin për ndarjen dhe shfrytëzimin e radio frekuencave, u konstatua se nuk ka radiofrekuencë të lirë për transmetim në radio të shërbimit programor në territorin e qytetit të Shkupit, gjegjësisht se për zonën e shërbimit - Qyteti i Shkupit nuk ka mundësi për përcaktimin e një alokimi të ri të frekuencës.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, vendimin e lartpërmendur ta publikon në ueb-faqen e Agjencisë.

Z. Petrushevski pas votimit tha, nëse propozuesi është këmbëngulës dhe nëse ka frekuencë të lirë në vitet e ardhshme do të ishte mirë që kërkesa të përsëritet.

Pikat 5 dhe 6

Z. Petrushevski propozoi që të dy pikat të shpjegohen me një hyrje, një diskutim dhe pastaj të votohet ndaras sepse bëhet fjalë për të njëjtën procedurë, fshirje nga regjistri i transmetuesve si pasojë e lejes tashmë të hequr të TV- KANAL VIS nga Strumica dhe BALKAN FM RADIO nga Gostivari.

Udhëheqësja Ljubevska i shpjegoi aktvendimet e propozuara për fshirje nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV - KANAL VIS SHPK Strumicë dhe Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJG Gostivar. Ajo ka shpjeguar se leja këtyre transmetuesve iu është hequr, TV Kanal Vis nga Strumica në vazhdimin e parë të seancës së 30-të të Këshillit, mbajtur më 24 korrik dhe RADIO BALKAN FM nga Gostivari në seancën e 31-të mbajtur më 29 korrik. Sipas LSHMAAV, duke marrë parasysh këto arsye, transmetuesit duhet të fshihen nga regjistri i transmetuesve të mbajtur nga Agjencia.

Votimi për pikën 5

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare për Radiodifuzion TV-KANAL VIS SHPKNJP Strumicë.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Votimi për pikën 6

Këshilli i Agjencisë njëzëri miratoi Aktvendim për fshirjen nga regjistri i transmetuesve të Shoqërisë Tregtare Radiodifuzive BALKAN FM RADIO SHPKNJP Gostivar.

Spektori për përkrahjen e punës së Drejtorit dhe Këshillit, Aktvendimin e lartpërmendur ta publikon në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut” dhe në ueb-faqen e Agjencisë.

Pika 7

Udhëheqësja e Sektorit për përkrahje të punës së drejtorit dhe Këshillit - shefe e kabinetit mr. Dragica Ljubevska, shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Test për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit dhe ueb-faqeve të Agjencisë. Ajo shpjegoi se kjo nevojë zbatohet me qëllim të identifikimit të pikave të dobëta të mundshme të sistemit të informacionit dhe komunikimit, të cilat duhet të jenë në pajtim me Ligjin për Mbrojtjen e të Dhënave Personale, i cili ka hyrë në fuqi në gusht të vitit 2021. Identifikimi i dobësive të mundshme është funksion i ndërmarrjes së hapave të mëtejshëm për mbrojtjen e plotë të të dhënave personale të përpunuara nga Agjencia. Shuma e përgjithshme e mjeteve të nevojshme për realizimin e këtij furnizimi është 250 mijë denarë pa TVSH, të cilat janë të parapara me planin financiar të Agjencisë për vitin 2024. Furnizimi është me vlerë të ulët dhe do të realizohet duke zbatuar dispozitat e Ligjit për Furnizim publik. Kriteri për dhënien e kontratës është raporti më i mirë ndërmjet çmimit dhe cilësisë, pra çmimi 50 pikë dhe cilësia 50 pikë.

Z. Petrushevski tha se është mirë që do të bëhet ky furnizim publik dhe shpreson se do të zgjidhet një kompani cilësore e cila me kohë do t'i zbulojë të gjitha problemet e mundshme, gjë që është e mirë për të ardhmen e sistemeve informative në Agjenci dhe për vetë faqet e internetit.

Z. Trajçev tha se do të bëjë vërejtje për të tri furnizimet publike që janë propozuar për këtë seancë. Sipas materialeve sheh se u jepen pikë për cilësinë në raport me çmimin. Këshilli i Agjencisë përcakton vetëm nevojën e furnizimit publik dhe nuk hyn në mënyrën e zbatimit, por parimisht mendimi dhe sugjerimi i tij personal është që të shmangen pikët e cilësisë, pra të vendoset kriteri më i ulët i çmimit për vlerësim në lidhje me cilësinë.

Z. Petrushevski deklaroi se do të mbështesë realizimin e furnizimit siç është propozuar, nuk bëhet fjalë për shpenzim të madh, por nga ana tjetër kërkohet njohuri eksperte. Ai tha se Këshilli nuk ka domosdoshmërisht të njëjtin mendim, por siç tha z. Trajçev, do të mbështesë propozimin si nevojë, e jo në detaje teknike.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Test për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit dhe faqeve të internetit të Agjencisë

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - shërbim: Test për sigurinë dhe qëndrueshmërinë e rrjetit dhe faqeve të internetit të Agjencisë është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, ndërsa mjetet sigurohen me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 8

Udhëheqësja Ljubevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Hulumtim - Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e përfaqësimit dhe prezantimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve. Ajo shpjegoi se realizimi i këtij furnizimi është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024. Shuma e përgjithshme e mjeteve të nevojshme për realizimin e kontratës është 650 mijë denarë pa TVSH, ndërsa dhënia e kontratës do të realizohet duke zbatuar procedurë të hapur të thjeshtuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizim publik. Kriteri për dhënien e kontratës është raporti ndërmjet çmimit dhe cilësisë, pra çmimi 40 pikë dhe cilësia 60 pikë.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik-shërbim: Hulumtim-Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e përfaqësimit dhe prezantimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - shërbim: Hulumtim - Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e përfaqësimit dhe prezantimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, ndërsa mjetet janë siguruar me Planin financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 9

Udhëheqësja Ljubevska shpjegoi Propozimin për dhënien e miratimit për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mbajtja e Ditëve të Arsimimit Mediatik 2024. Ajo shpjegoi se zbatimi i këtij furnizimi është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë, dhe mjetet janë siguruar me Planin Financiar të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024. Shuma e përgjithshme e mjeteve të nevojshme për realizimin e furnizimit është 1 milion e 500 mijë denarë pa TVSH. Lënda e furnizimit publik është zgjedhja e një operatori ekonomik i cili duhet të hartojë dhe të krijojë një imazh dhe fushatë reklamuese për Ditët e Arsimimit Mediatik 2024, material promovues dhe të zbatojë të gjitha aktivitetet e nevojshme për realizim, përfshirë dhe konferencë një ditore. Dhënia e kontratës do të realizohet duke zbatuar një procedurë të hapur të thjeshtuar në pajtim me dispozitat e Ligjit për furnizim publik, dhe kriter për dhënien e kontratës është sërish raporti ndërmjet çmimit dhe cilësisë, pra çmimi 25 pikë dhe cilësia 75 pikë.

Z. Trajçev tha se do të diskutojë sërish për raportin çmim-cilësi. Këshilli nuk ka kompetencë të marrë pjesë në specifikimin (përcaktimin) teknik të drejtorit dhe Shërbimi Profesional është se si do ta zbatojnë procedurën, Këshilli voton vetëm për përcaktimin e nevojës. Por kjo marrëdhënie ku çmimi është vetëm 25 për qind për të është shumë e

çuditshme dhe sugjerimi i tij është të ndryshohet. Megjithatë, Këshilli nuk ka kompetencë në atë pjesë dhe vetëm mund të japë mendimin e tij.

Z. Fidanoski shtroi pyetje në lidhje me furnizim publik të vitit të kaluar për Ditët e Arsimimit Mediatik 2023, cili ishte raporti çmim-cilësi? Sepse nëse viti i kaluar ka pasur të njëjtin raport me atë aktual, ai shprehu se vitin e kaluar ka pasur organizim dhe realizim cilësor të Ditëve të Arsimimit Mediatik dhe ASHMA-ja është paraqitur me sukses në dritën e duhur siç i ka hije si një prej liderëve të kësaj fushe në Maqedoni. Sugjerimi i tij është në pajtim me atë që tha z. Trajçev, se ndoshta raporti i çmimit 30 pikë dhe i cilësisë 70 pikë nuk do të jetë i keq sepse edhe ky furnizim, si dy të mëparshmet, janë furnizime delikate. Pika për Hulumtim - Analiza e çështjeve gjinore dhe mënyra e paraqitjes dhe përfaqësimit të grave dhe burrave në programet e transmetuesve është detyrim ligjor i Agjencisë, i cili më vonë përdoret si material në punën e Kuvendit. Gjithashtu, dhe furnizimi për Testin e Sigurisë dhe Qëndrueshmërisë së rrjetit dhe faqeve të internetit të Agjencisë, është i rëndësishëm sepse janë të mundshme ndërhyrjet e hakerëve dhe bllokimi i sistemit, dhe llogarit se çmimi nuk duhet të jetë kriteri parësor, duhet të zgjidhen oferta cilësore që do të ofrojnë besueshmëri, stabilitet dhe realizim cilësor të kërkesave të Agjencisë nga operatorët ekonomikë që do të nënshkruajnë marrëveshje për furnizim publik. Ai deklaroi se do ta mbështesë edhe këtë pikë dhe propozoi që raporti të jetë çmimi 30 pikë dhe cilësia 70 pikë nëse Shërbimi profesional nuk ka kundërshtim.

Udhëheqësja Ljubevska në lidhje me pyetjen e z. Fidanoski u përgjigj se raporti i furnizimit publik të vitit të kaluar për Ditët e Arsimimit Mediatik 2023 është identik me atë aktual, gjegjësisht çmimi 25 pikë dhe cilësia 75 pikë. Ajo ka shpjeguar se këto kritere janë formuar në bazë të përvojave të mëparshme që Agjencia ka pasur për këtë furnizim publik. Në fillim, kur filloi të kryhet ky lloj furnizimi dhe çmimi ishte kriter vendimtar, u pranuan oferta shumë të këqija dhe për këtë Shërbimi profesional duhej të bënte atë që duhej të punonte operatori ekonomik, për të cilin ai kishte nënshkruar Marrëveshje, dhe me qëllim që Ditët e Arsimimit Mediatik të mbahen në nivel cilësor.

Z. Fidanoski tha se tërhiqet nga sugjerimi i tij për korrigjimin e raportit të çmimit 30 pikë dhe cilësisë 70 pikë. Ai konsideron se propozimi është i mirë për çmim 25 pikë dhe cilësi 75 pikë, sepse furnizimi i vitit të kaluar është realizuar në cilësi të plotë.

Z. Petrushevski tha se do ta mbështesë propozimin dhe beson në arsyetimin e tij.

Z. Trajçev tha se do të ndërlihet me atë që ka thënë udhëheqësja Ljubevska, gjegjësisht argumenti se më parë ka pasur operatorë të këqij sepse kriter ka qenë çmimi më i ulët. Ai mendon se nuk justifikohet për arsye se mund të vendosen kritere në të cilat do të marrin pjesë operatorët që i plotësojnë kushtet, dhe nga ana tjetër, në vetë kushtet e Marrëveshjes, nëse ata nuk veprojnë sipas asaj që është shkruar në marrëveshjes, ka mekanizma dhe mënyra të aktivizimit të garancive dhe të ngjashme. Agjencia nuk mund të punojë nëse ndonjë operator tashmë ka lidhur kontratë dhe për këtë marrin mjete që janë para shtetërore dhe për të cilat Këshilli duhet të sigurohet që ato të përdoren për qëllimin e synuar. Ka mënyra dhe mekanizma që çdo operator që paraqitet dhe që konkuron për atë furnizim publik të përfundojë punën e tij, përndryshe Agjencia ka mekanizmat e saj. Në fund ai tha se mbetet në qëndrimin e tij që ky lloj furnizimi nuk duhet të bëhet me këtë raport në përgjithësi, vetëm duhet të vendosen kritere të tjera për të shmangur operatorët e këqij dhe të mos ketë vendim subjektiv të Agjencia për të vlerësuar cilësinë, por ajo duhet të jepet me kritere dhe kushte të përcaktuara qartë. Ai shpjegoi se megjithatë Këshilli nuk e ka këtë kompetencë, por

voton vetëm për nevojën e furnizimit publik, procedura dhe mënyra e zbatimit është kompetencë dhe përgjegjësi e Agjencisë.

Z. Ajdini tha se do të mbështesë zbatimin e furnizimit publik. Ditët e Arsimimit Mediatik mbahen në javën e fundit të tetorit, dhe ajo javë përputhet me 27 tetorin, Ditën Botërore të Trashëgimisë Audio dhe Audiovizuale të miratuar nga UNESCO në 2005, e cila ka të bëjë me mbrojtjen dhe ruajtjen e trashëgimisë filmike dhe kulturore me qëllim të rrisë ndërgjegjësimin e publikut për rëndësinë e mbrojtjes së këtij lloji të të dhënve. Ai këtë e thotë sepse vitin e kaluar kur u mbajtën Ditët e Arsimimit Mediatik ka pasur një intervistë në programin e Radios së Maqedonisë në gjuhën shqipe dhe të gjitha pyetjet ishin në këtë temë, a e përkujton ASHMA këtë ditë, sepse UNESCO i inkurajon të gjithë kudo që t'i bashkohen festës së 27 Tetorit, duke prezantuar koleksionet e tyre të vlefshme, në mënyrë që brezat e sotëm dhe të ardhshëm të shijojnë këtë thesar që përfaqëson trashëgiminë tonë të përbashkët. Ai e di se ndoshta ASHMA nuk është më kompetenti për këtë, por në bashkëpunim me institucione të tjera, për shembull me Kinematekën e Maqedonisë apo me mediat, mund ta shënojë këtë ngjarje, ta shtojë në program kur do të mbahen Ditët e Arsimimit Mediatik.

Z. Fidanoski tha se nuk do të donte që z. Trajçev ta kuptojë se po e replikon, por sipas tij bëhet fjalë për një furnizim kompleks që përmban disa elemente të ndryshme që duhet të integrohen në një tërësi që do të jetë adekuate dhe cilësore. Ai pajtohet me të që mund të vendosen kritere të cilat nëse nuk plotësohen nga operatori që do të kryen furnizimin, atëherë ai ka mundësi të kompensohet në një mënyrë tjetër, të sanksionohet, por do të jetë siç thotë populli “pas dasmës daullet”, sepse në atë javë të arsimimit mediatik kur duhet një realizim funksional i furnizimit, do të kalojë me një sërë gjërash të munguara dhe me dritën në të cilën Agjencia do të prezantohet si organizatore dhe një nga bartësit e Arsimimit Mediatik në Maqedoni do të errësohen në një farë mënyre. Prandaj ai beson se gjithmonë është e nevojshme të vlerësohet se cila është oferta më e mirë dhe cilat janë kriteret që duhet të vendosen, por ai gjithmonë ka mbrojtur parimet si z. Trajçev, për parimet e tij, që për disa furnizime raporti i cilësisë dhe çmimit duhet të ekzistojë dhe të jetë i balancuar për të marrë ofertën më të mirë të mundshme.

Z. Petrushevski tha se do të mbështesë furnizimin ashtu siç është propozuar në atë kuptim siç tha z. Trajçev për nevojën dhe nuk do të hyjë në detaje teknike sepse ka argumente në atë që tha z. Trajçev, dhe kemi të bëjmë edhe për besim, nëse ka besim tek Shërbimi Profesional dhe nëse ai e kryen punën e tij në mënyrë profesionale dhe të paanshme, nuk ka dyshim se furnizimi do të kryhet me drejtësi.

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për zbatimin e procedurës për furnizim publik - shërbim: Mbajtja e Ditëve të Arsimimit Mediatik 2024.

Zbatimi i procedurës për furnizim publik për lëndën - shërbim: Mbajtja e Ditëve të Arsimimit Mediatik 2024, është parashikuar dhe është në pajtim me Planin vjetor për furnizim publik për vitin 2024 të Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale nr.05-4729/1 datë 22.12.2023, ndërsa mjetet janë siguruar nga Plani Financiar i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 10

Këshilli i Agjencisë njëzëri dha miratim për pagesën e ndihmës financiare – dëmshpërblim për vdekjen e anëtarit të familjes së ngushtë – prindi (nënë), të punësuarit në

Sektorin për planifikim strategjik dhe të drejtat e autorit, në Agjencin për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuale, në shumë prej 15.000,00 (pesëmbëdhjetë mijë) denarë.

Mjetet e lartpërmendura sigurohen nga Plani Financiar i Agjencisë së Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuale për vitin 2024.

Pika 11

Të ndryshme

Nuk ka pasur diskutim nën Të ndryshme.

**Agjencia për Shërbime Mediatike
Audio dhe Audiovizuale
Kryetari i Këshillit,
Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**